

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-193/13

**Prishtinë,
23 korrik 2015**

Në çështjen juridike të:

J. T.

Mali i Zi

Pala ankuese/Paraqitësi i kërkesës

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët, Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Èillem Brouëer dhe Rolandus Bruin, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA28617) të datës 5 shtator 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 23 korrik 2015, mori këtë

AKTGJYKIM

Hedhet poshtë ankesa e paraqitur nga J.T. e datës 16 korrik 2013, e regjistruar me numrin GSK-KPA-A-193/2013, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/164/2012 të datës 5 shtator 2012 lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA28617, si e paafatshme.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 15 mars 2007 pala ankuese, atëherë paraqitësi i kërkesës J. T. në cilësinë e anëtarit të familjes së ngushtë të bartësit të pretenduar të së drejtës pronësore ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkon të drejtën pronësore dhe ri-posedim të ngastrave kadastrale me numrat 519/10 dhe 520/1, me sipërfaqe prej 0ha 89ari 97m², Zona Kadastrale Rastavicë, Komuna e Deçanit (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar).
2. Për të mbështetur ankesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar këto dokumente:
 - Vendimin administrativ nr. 07-952/2-125/95 të lëshuar nga Shërbimi i Kadastrit të Pronës së Paluajtshme i Komunës së Deçanit më 19 tetor 1994;
 - Gjetjet e ekspertit nga Dr. Milivoje Jarović të Zyrës Kadastrale Republikane, Administrimit dhe Paluajtshmërisë, të datës 14 maj 1996. Ky dokument mes tjerash synon të shpjegoj historikun kadastral të ngastrave me numrat 519/10 dhe 520/1 dhe që të përgjigjet në pyetjen nëse çmimi shitëblerës i parcelës në vitin 1963 ishte çmimi real i tregut;
 - Certifikatën e lindjes të nënës së palës ankuese të lëshuar nga Komuna e Nikshiqit (Mali i Zi) më 7 mars 1997;
 - Certifikatën e lindjes të paraqitësit të kërkesës të lëshuar nga Komuna e Cetinjes (Mali i Zi) më 15 gusht 2008;
 - Njoftimin përkujtimor që tregon se nëna e paraqitësit të kërkesës M. T. kishte vdekur më 11 janar 1996; dhe
 - Letërnjoftimin e paraqitësit të kërkesës me numrin CG00619201 të lëshuar nga autoritetet e Malit të Zi më 26 prill 2006.
3. Më 25 qershor 2008, AKP kishte bërë njoftimin e kërkesës. Prona e kërkuar ishte gjetur e lirë. Më 1 korrik 2010 AKP-ja përmes publikimit në gazetën e AKP-së kishte vërtetuar njoftimin e pronës së kërkuar. Gazeta dhe Lista ishin lënë te Kryesuesi i fshatit Rastavicë, si dhe në hyrje dhe në tabelën publike në dalje të fshatit. Shpallja e njëjtë (lista dhe gazeta) është

- publikuar në Komunën e Deçanit-Zyrën e Avokatit Publik, Zyrën Kadastrale të Komunës së Deçanit, Gjykatën Komunale të Deçanit dhe Zyrën Rajonale të AKP-së në Pejë. Gazeta e AKP-së është shpërndarë edhe te DRC, OSCE, UNHCR, dhe te Ombudspersoni.
4. Sipas raportit të verifikimit të AKP-së të datës 15 korrik 2009, Vendimi administrativ nuk ishte gjetur. Zyrëtar i Departamentit të Kadastrit i Komunës së Deçanit ka theksuar ky Vendim administrativ është lëshuar nga institucionet paralele serbe; Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të AKP-së të datës 24 janar 2011, me përjashtim të vendimit administrativ nr. 07-952/2-125/95 të datës 19 tetor 1994, Çertifikata e lindjes dhe leternjoftimi janë verifikuar pozitivisht.
 5. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) në vendimin e saj KPCC/D/A/164/2012 të datës 5 shtator 2012 ka hedhur poshtë kërkesën e palës ankuese mbi bazën se “[...*paraqitësi i kërkesës pranon se bartësi i pretenduar i të drejtës së pronësisë i ka shitur pronën e kërkuar qysh në vitin 1963 ndërmarrjes shoqërore Ereniku*]”. Prandaj, vendimi i njëjtë përmend se humbja e pretenduar e posedimit nuk mund të konsiderohet se rezulton nga konflikti i vitit 1998-1999. Kjo dmth se kërkesa bie jashtë jurisdikcionit.
 6. Vendimi i është dorëzuar palës ankuese më 17 prill 2013. Ai ka paraqitur ankesë. Qendëra e AKP-ës në Prishtinë – ka pranuar shkresën e ankesës, e cila përmban datën ‘03 05 2013’, me datë 16 korrik 2013. Personi punës në AKP, Tanja Mijatović, thekson se shkresa e ankesës me vulën e avokatit në të është pranuar ...”të premtën e javës së kaluar’ ndërsa deklarata daton nga prej të Mërkurës 17 korrik 2013. Ajo gjithashtu thekson që ankuesi nuk ka mundur ta kontaktoj AKP paraprakisht meqë lidhjet telefonike dhe rryma ishte ndërprerë.

Pretendimet e palës ankuese

7. Pala ankuese thekson se vendimi i KKPK-së mbështetet mbi vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të fakteve dhe mbi zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Kjo për shkak se ai thekson se në kërkesën e dorëzuar kronologjia është shqyrtuar gabimisht dhe kërkesa është hedhur poshtë me anë të vendimit pa vërtetuar paraprakisht faktet.
8. Ai ka sqaruar se nëna e tij M. T. [(në tekstin e mëtejshëm: bartësja e pretenduar të drejtës pronësore (BDP)] është pronare e pronës së kërkuar. Ai ka theksuar se prona e kërkuar është humbur më 12 qershor 1999 dhe se humbja ka qenë si rezultat i rrethanave gjatë viteve 1998/1999 në Kosovë. Ai ka shtuar se ai nuk e din se kush e përdor pronën e kërkuar.
9. Pala ankuese gjithashtu thekson se baza ligjore e vendimit të KKPK-së nuk është plotësisht e qartë. Kjo për shkak se procedurat e kryera gjyqësore lidhur me vërtetimin e së drejtës pronësore mbi pronat e kërkuara pranë Gjykatës Komunale të Pejës kundër NSH Ereniku

janë ndërprerë për shkak të konfliktit të vitit 1998/1999 dhe kjo duhet të merret në konsideratë si humbje e pronës që nga rezultuar nga ai konflikt.

Pala ankuese e konsideron të domosdoshme “që të kthehet mbrapsht vendimi ilegal i kundërshtuar, përcaktimin se çfarë kërkon paraqitësi i kërkesës me kërkesën e tij dhe pastaj të merret një vendim mbi meritat”.

Në fund, pala ankuese propozon që Gjykata Supreme e Kosovës si gjykatë e shkallës së dytë të pranoj ankesën e paraqitur dhe pas shqyrtimit të pretendimeve “të kthej mbrapshtë” vendimin e kundërshtuar dhe të dërgoj lëndën në rigjykim dhe për vendimmarrje të re.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës:

10. Ankesa është e papranueshme sepse është paraqitur jashtë afatit sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e ndryshuar me ligjin nr. 03/L-079 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale (në tekstin e mëtejme Ligji 03/L-079) i cili parasheh që *“brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e njoftimit të palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit lidhur me kërkesën, pala përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës mund të dorëzoj ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër një vendimi të tillë”*.
11. KKKP vendosi lidhur me këtë lëndë me vendimin e saj KPCC/D/A/164/2012 të datës 5 shtator 2012. Ky vendim i është dorëzuar palës ankuese më 17 prill 2013. Megjithatë, pala ankuese, kishte paraqitur ankesë e cila ishte pranuar nga AKP-ja jo më heret se 12 korrik 2013 (gati dy muaj më vonë se afati i dorëzimit të ankesës), ashtu siç shihet nga informata e AKP në lëndë dhe që u theksua në paragrafin 6.
12. Gjykata nuk ka mundur të gjej asnjë arsye për ta justifikuar palën ankuese për këtë vonesë. Ai është paralajmëruar mjaftueshëm për afatin e dorëzimit (vendimi përmbante një paralajmërim në gjuhën serbe) ndërsa vet pala ankuese nuk kishte dhënë asnjë arsye për vonesën.
13. Në bazë të asaj që u tha më lartë dhe në përputhje me nenin 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 195.1(a) të Ligjit të Procedurës Kontestimore, ankesa duhet të hidhet poshtë si e paafatshme.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it